



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 120

Prishtinë, më 8.7.2013, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Mungoi : Boban Todorović, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.6.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Planifikim Hapësinor,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratet mjedisore,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi,
6. Shqyrtimi i Projektligjit në parim për Kimikate,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.6.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26.6.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Planifikim Hapësinor

Kryetari Nait Hasani ftoi komisionin dhe bashkëpunëtorët në definimin përfundimtar të amendamenteve të deritanishme të cilat u votuan nga Komisioni si vijon :

Amendamenti 1

Neni 3, riformulohet **Paragrafi 9** si vijon :

“Zonë Urbane”- është zona e cila fizikisht formon pjesën e një qyteti dhe karakterizohet me pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, densitetit të lartë të popullsisë dhe banimit, punësim dhe transport të konsiderueshëm dhe infrastrukturë tjetër. Zonat urbane mund gjithashtu të përmbajnë zona të gjelbra zakonisht të shfrytëzuara për qëllime rekreative.

Riformulohet **Paragrafi 12** si vijon :

“Zonë Banimi”- Sipërfaqe e caktuar kryesisht për qëllime të banimit.

Pas **Paragrafit 12** shtohet një paragraf i ri :

“Perimetri” - nënkupton kufirin zyrtar të një territori me karakteristika të përbashkëta, të zhvillimit, mbrojtjes dhe ruajtjes.

Paragrafi 23, riformulohet si vijon:

“Vija Rregullative” nënkupton vijën kufizuese në mes të ngastrës së ndërtimit dhe të drejtës së shfrytëzimit të rrugës publike.”

Paragrafi 24, riformulohet si vijon:

“Vija e Ndërtimit” nënkupton vijën kufizuese cila definon se ku është i lejuar ndërtimi në ngastrën ndërtimore.”

Paragrafi 30, riformulohet si vijon :

“Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor” – dokumenti i cili përcakton kërkesat themelore për hartimin e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Paragrafi 35, titulli i paragrafit **“Databaza e Konsoliduar e Planifikimit Hapësinor”** riformulohet **“Baza e të dhënave të Planifikimit Hapësinor”** dhe në tërë tekstin e Projektligjit fjala **“Databaza”** zëvendësohet me **“Baza e të dhënave”**.

Amendamenti 2

Neni 4, Paragrafi 1.8, pas fjalës **“hartimin”** hiqet fjala **“dhe zbatimin”**.

Amendamenti 3

Neni 6, paragrafi 1, në reshtin e tretë pas fjalës **“që”** fshihet **“burojnë nga/dhe”** dhe vazhdon teksti si në projektligj.

Amendamenti 4

Neni 7, Pas **Paragrafit 2.2**, shtohet një paragraf i ri si vijon :

2.3. “Hartës zonale të Kosovës pasi të aprovohet nga Qeveria e Kosovës.”

Paragrafi 2.4 , fshihet.

Amendamenti 5

Neni 8, tek **Paragrafi 2.2, 2.4 dhe 2.5** pas fjalës **“aprovimin”** fshihet **“përfundimtar”**.

Amendamenti 6

Neni 8, pas paragrafit 3 shtohet një paragraf i ri :

“Qeveria Kosovës rregullisht koordinon dhe harmonizon politikat dhe strategjitë sektoriale të Ministrive relevante.”

Amendamenti 7

Neni 9, në fillim të nënparagrafit 1.2 shtohet : **“hartimin dhe”** dhe vazhdon teksti.

Riformulohet **Nënparagrafi 1.3 :**

“përgatitjen e propozim-vendimeve për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe Hartës Zonale të Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta, si dhe për revidimin e tyre. Propozim-vendimit i bashkëngjitet programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i cili përmban të dhënat në vijim:”

Nënparagrafi 1.4, fjalia **“bashkërendimin e hartimit të”** zëvendësohet me **“hartimin dhe bashkërendimin e”**.

Nënparagrafi 2.1, në fund pas fjalës **“dhe”** shtohet **“planet rregulluese të hollësishme”**.

Nënparagrafi 2.3. riformulohet si vijon :

“bashkërenduar vlerësimin e përputhshmërisë së Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës dhe përputhshmërinë me planin hapësinor të Kosovës dhe Hartës zonale të Kosovës, si dhe të revidimit të tyre me të Dhënat Digjitale Bazë dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe me vendim njofton autoritetin përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor për :”

Nënparagrafi 2.3.1, **“pesëmbëdhjetë (15)”** zëvendësohet me **“tridhjetë (30)”**.

Nënparagrafi 2.3.2, **“pesëmbëdhjetë (15)”** zëvendësohet me **“tridhjetë (30)”**.

Nënparagrafi 2.3.3, **“pesë (5)”** zëvendësohet me **“dhjetë (10)”**.

Amendamenti 8

Neni 11, Nënparagrafi 1.1 në fillim pas fjalës **“zhvillimin”** fshihet **“e planifikimit”**.

Paragrafi 1.2. riformulohet :

“përgatitjen e propozim-vendimeve për hartimin e Planit Hapësinor të Komunës dhe Hartës Zonale të Komunës dhe Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta, si dhe për revidimin e tyre. Propozim-vendimit i bashkëngjitet programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i cili përmban të dhënat në vijim:”

Nënparagrafi 1.8. bartet i pandryshuar pas nënparagrafit 1.1. të këtij Neni.

Në Nënparagrafin 1.15, fshihet në fillim të fjalisë **“zbatimin e”**.

Amendamenti 9

Neni 12, Paragrafi 1, riformulohet si vijon:

“Plani Hapësinor i Kosovës është një dokument multi-sektorial i cili identifikon në aspektin hapësinor politikat zhvillimore sociale, ekonomike dhe mjedisore me qëllim të krijimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar në tërë territorin e Kosovës.”

Paragrafi 2, pas fjalës **“shqyrton”** shtohet **“dhe vlerëson”**.

Nënparagrafi 2.6, riformulohet si vijon: **“kërcënimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera si dhe ndotjet dhe degradimin e mjedisit dhe”**.

Paragrafi 3 riformulohet si vijon :

“Plani Hapësinor i Kosovës përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Kosovës.”

Amendamenti 10

Neni 13, riformulohet Nënparagrafi 2.7. si vijon :

“mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe ndotja e degradimi i mjedisit”.

Pas Nënparagrafit 2.7. shtohet një Nënparagraf i ri :

“zvogëlimin dhe minimizimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,”

Nënparagrafi 3.3. fjala **“ agrikulturë”** zëvendësohet me **“bujqësi”** dhe i tërë nënparagrafi zhvendoset pas paragrafit 3 të neni 12.

Nënparagrafi 3.4 dhe 3.5 zhvendosen te Neni 4 pas nënparagrafit 1.10.

Termi **“Normat Evropiane”** në tërë tekstin e projektligjit zëvendësohet me **“Normat e BE”**.

Amendamenti 11

Neni 14 zhvendoset pas Nenit 18.

Paragrafi 4.6. riformulohet si vijon: **“planifikimi hapësinor urban dhe rural nga niveli lokal”.**

Paragrafi 5 fjala **“Ministria”** zëvendësohet me **“Qeveria”**.

Amendamenti 12

Neni 15, Nënparagrafi 2.2. fjala **“rezidenciale”** zëvendësohet me **“banimit”**.

Nënparagrafi 2.4 riformulohet si vijon: **“mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe ndotja dhe degradimi i mjedisit”.**

Paragrafi 3 riformulohet si vijon: **“Hartimi i Planeve hapësinore për zonat e veçanta bazohet në:”**

Nënparagrafi 3.1. në fund fshihet fjala **“ dhe arkeologjike”**.

Paragrafi 5, fjala **“Nëse”** në fillim të paragrafit zëvendësohet me **“Aty ku”**.

Paragrafi 6, fjala **“dhjetë (10)”** zëvendësohet me **“tete (8)”**.

Paragrafi 7, riformulohet si vijon :

“Të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës do të publikohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës”.

Ky paragraf zhvendoset te Neni 7 pas paragrafit 3 dhe merr numrin 4.

Amendamenti 13

Neni 16, Paragrafi 1 riformulohet si vijon :

“Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.”

Paragrafi 2, pas fjalës **“shqyrton”** shtohet **“dhe vlerëson”**.

Nënparagrafi 2.5. riformulohet si vijon :

“mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe ndotja dhe degradimi i mjedisit”.

Nënparagrafi 2.6. para fjalës **“trashëgimisë”** shtohet **“mbrojtjes së”**.

Paragrafi 3, pas fjalës **“parimet”** shtohet **“objektivat”** dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 14

Neni 17, Nënparagrafi 2.2, fjala **“rezidenciale”** zëvendësohet me **“të banimit”**.

Nënparagrafi 2.7. riformulohet si vijon: “mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe ndotja dhe degradimi i mjedisit”.

Nënparagrafi 2.8. para fjalës “trashëgimisë” shtohet “mbrojtjen e”.

Fshihen nënparagrafët 3.1, 3.2, 3.4, 3.5,

Nënparagrafi 3.3 riformulohet si në vijim :

“objektivat e planeve zhvillimore strategjike të sektorëve të ndryshëm të Qeverisë dhe Komunës, për administratë publike, arsim, shkencë dhe teknologji, agrikulturë, pylltari, zhvillim rural, siguri publike, trashëgimi kulturor, ngjarje kulturore, sport, mjedis, mirëqenie sociale, shëndetësi, infrastrukturë, ekonomi, tregti, industri, telekomunikacion, transport publik, shpërndarje të energjisë elektrike dhe termike”.

Nënparagrafi 3.6 pas fjalës “qëndrueshëm” fshihet “dhe proporcional të komunitetit”.

Nënparagrafi 3.7. fshihet “drejtë të”.

Amendamenti 15

Neni 18, Paragrafi 1 riformulohet si vijon :

“Komunat, varësisht nga nevojat për zhvillim hapësinor mund të përgatisin Plane Rregulluese të Hollësishme për të gjitha ose për cilëndo nga zonat e përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës.”

Amendamenti 16

Neni 19, Paragrafi 1, riformulohet si vijon :

“Ministria krijon, organizon, përditëson dhe mirëmban bazën e të dhënave të Planifikimit Hapësinor për shfrytëzim të brendshëm nga organet qendrore dhe ato lokale si dhe për qasje publike në dokumentet e planifikimit hapësinor, brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

Amendamenti 17

Neni 21, Paragrafi 2 riformulohet si në vijim :

“dokumentet e planifikimit hapësinor duhet t’i përcaktojnë kushtet ndërtimore për territorin përkatës, të përcaktuara sipas Paragrafit 1 të këtij neni”.

Nënparagrafi 5.1. riformulohet :

“numri rendor i parcelës kadastrale dhe i zonës kadastrale”.

Nënparagrafi 5.3. Fjala “rregullative”, zëvendësohet me “rregulluese”.

Nënparagrafi 5.8. riformulohet si vijon :

“përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale”.

Nënparagrafi 5.9. riformulohet si vijon :

“përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale”.

Amendamenti 18

Neni 26, Paragrafi 4 riformulohet si vijon :

“Me përjashtim të Komunave të cilat janë në proces të shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal, të gjitha Komunat të cilat nuk posedojnë Planin Zhvillimor Komunal të miratuara nga Ministria dhe Kuvendi Komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, hartojnë dhe aprovojnë dokumentet e planifikimit hapësinor në pajtim me dispozitat e këtij ligji.”

Pikat e radhës të rendit të ditës mbetën për mbledhjen e radhës, përveç që Projektligji për Kimikate u përcjellë për leximin e parë.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani